

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Erdogan Haxhibeqiri kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H.Sh., nga fshati Barilevë – Komuna e Prishtinës, të cilin me autorizim e përfaqëson M. H., avokate nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë, objekti i kontesti shpërblimi i dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1191/2015 datë 22.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.09.2018 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1191/2015 datë 22.01.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1191/2015 datë 22.01.2018, është pranuar ankesa e të paditurit dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2904/2013 datës 27.11.2014, ashtu që është refuzuar kërkesëpadia e paditësit me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë që të njëjti të shpërblehet në emër të dëmit materiale dhe jo material dhe atë: Në emër të dhimbjeve fizike 450 €, në emër të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm mjekësor shumën prej 8.000 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000 €, në emër të kujdesej dhe ndihmës së personit të tret shumën prej 200 €, në emër të ushqimit të përforcuar 200 €, në shumën e përgjithshme 15.900 € të gjitha këto me kamatë prej 3,5% duke llogaritur nga data shkaktimit të dëmit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe është vendosur që se cila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë paditësi në afta ligjor ka paraqitur revizion, të cilën e godet për shkak shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin

182 al.2 pika n dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se revizioni i paditësit është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pran gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar fakti se paditësi ka qen në marrëdhënie pune te e paditura, me datën 02.04.2000 duke udhëtuar nga vendbanimi i tij në fshatin ..., për në punë tek e paditura me autobusin e të paditurës, duke zbritur në hyrje objektit të paditurës, punëtori i KEKU-të A. M., me automjeti privat ka goditur paditësin. Me këtë rast paditësi pëson lëndime të rënda trupore me pasoja të përjetshme dhe i ka kërkuar që e paditura në bazë të nenit 67 dhe 68 rregullores së përkohshme për marrëdhënie pune në KEK të datës 08.03.2000 në lidhje me nenin 122 të Ligjit të marrëdhënies së punës (1999) si dhe dispozitave të nenit 189 dhe 200 Ligjit mbi marrëdhënien e punës të shpërblej dëmin e shkaktuar paditësit .

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në kuptim të dispozitës së nenit 67 dhe 68 të Rregullës së përkohshme të KEKU-të dhe në bazë të nenit 122 të ligjit të marrëdhënies së punës të vitit 1989, e paditura ka për obligim që paditësit të shpërblejë dëmin në lartësinë të aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të saj. Lidhur me lartësinë e dëmit gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitat e nenit 189 dhe 200 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plot gjendje faktike, gabimisht ka zbatuar të drejtës materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për arsye se nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës, gjegjësisht nuk ka kurrfarë baze të përgjegjësisë së të paditurës, pasi që dëmi paditësit nuk i është shkaktuar në punë tek e paditura, por dëmi është shkaktuar nga personi i tretë, punëtori i të paditurës A.M., i cili ka goditur paditësin jashtë vendi të punës dhe atë në aferës të oborrit të paditurës duke shkaktuar lëndime të rënda trupore. Kërkesa e paditësit për shpërblim të dëmit sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk ka mbështetje me nenin 60 paragrafi 1 të Ligjit të punës si dhe në dispozitën e nenit 154 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Duke u nisur nga gjendja e tillë çështjes Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plot të gjendjes faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë drejt i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe e drejtën material, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësi është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit përmban arsye të mjaftuar për faktet relevante të vlefshme për gjykim të drejt të kësaj çështje juridike.

Gjykata Supreme i ka vlerësuar si të pabazuar thëniet e paditësit të cekura në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 182 al 2 pika n të LPK-së nga se siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit [është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës se arsyetimi nuk përmban arsye lidhur me faktet përse gjykata ankimore ka gjetur se gabimisht është zbatuar e drejta materiale, sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tjera të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit të është i qartë dhe në harmoni me provat e administruara kur gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit nuk është e bazuar në dispozitat ligjore.

Aktgjykimi i goditur ka arsye të mjaftuar dhe bindëse të pranuar nga kjo gjykatë.

Gjykata Supreme vlerëson se një rast mund të pranohet si lëndim në punë në qoftes ajo ngjarje të ketë karakter të punës, gjegjësisht që të ketë lidhje kohore , hapësinore dhe shkakore me obligimet e punës së rregullt të paditësit. Lëndimet që ka pësuar paditësi në hyrje të oborrit të paditurës nga personi i tretë, nuk është shkaktuar gjatë kryerjes së punës dhe nuk ka lidhje kauzale me punën e paditësit, prandaj në bazë të dispozitave të nenit 122 të Ligjit për marrëdhëniet e punës (Gazeta Zyrtare e KSA Kosovës numër 12/39 dhe nenit 154 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimit (Gazeta Zyrtare të RSPJS numër 29/78 të aplikueshme sipas rregullores së UNMIKU-të numër 1999/24 dhe neneve 67 -68 të Rregullave të përkohshme të paditurës për marrëdhëniet të punës të datë 08.03.2000 paditësit nuk i takon shpërblimi i dëmit për lëndimet e pësuar pasi që nuk janë shkaktuar gjatë kryerjes së punës as lidhur me punët në bazë të dispozitave të cituara e për këtë i padituri nuk është përgjegjës për shpërblimin e dëmit paditësit. Prandaj edhe thëniet e revizionit të paditësi se për dëmin e shkaktuar e paditësi është përgjegjës e paditura nuk qëndrojnë.

Vlen të theksohet se shumt të cilat janë refuzuar nga ana e Gjykatës së apelit janë të shënuara gabimisht dhe janë të larta e që kjo mund të jetë gabim teknik gjatë hartimit të aktgjykimit

Nga arsyet e dhëna më lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit në bazë të nenit 222 të LPK-së

GJYKATA SUPREM E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.145/2018 datë 06.09.2018

Kryetar i kolegjit
Erdogan Haxhibeqiri